

02/2022

Zbatimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Qeverisë

RAPORT I MONITORIMIT



Autori: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Programi: Qeverisja Demokratike

Data e publikimit: Mars 2022



Qeverisja Demokratike
Democratic Governance

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Të gjeturat, qëndrimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
Përmbledhje e përgjithshme sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike.....	6
Raporti i Zbatimit.....	7
Masa 1 - Mbështetja e Punësimit.....	7
Niveli i Zbatimit	8
Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit.....	10
Niveli i Zbatimit	11
Masa 3 - Mbështetja për familjen.....	12
Niveli i Zbatimit	13
Masa 4 - Mbështetja për publikun.....	15
Niveli i Zbatimit	16
Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient.....	17
Përfundime.....	18

Lista e shkurtesave

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

APRK – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

INDEP – Instituti për Politika Zhvillimore

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit

ME – Ministria e Ekonomisë

MFPT – Ministria e Financës, Punës dhe Transfereve

MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MSH – Ministria e Shëndetësisë

TI – Teknologjia e informacionit

Hyrje

Pandemia COVID-19 ka shkaktuar dëme dhe ka lënë pasoja të mëdha, që prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose ndryshe çdo qytetar, gati në çdo aspekt të jetesës. Pasojat e kësaj pandemie janë afatgjate, dhe po bëhen çdo herë e më të dukshme, duke përfshirë kështu sferën ekonomike, sociale, mjedisore e madje edhe atë politike, duke u bazuar gjithmonë në ngjarjet e fundit. Me gjithë dëmet e shkaktuara, ekosistemet njerëzore kanë aftësinë të rigjallërojnë veten dhe të rikthehen në paternet e vjetra. Por për të ndihmuar një rikthim më të shpejtë, njëkohësisht të gjelbër, qeveri të ndryshme kanë krijuar ndihma në formë pakosh që përveç që kanë ndihmuar rigjallërimin ekonomik, janë munduar që të orientojnë atë drejtë një modeli të gjelbër dhe të qëndrueshëm.

Edhe qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë periudhës së pandemisë ka tentuar të ndihmojë dhe zbusë pasojat ekonomike e sociale të qytetarëve të saj, përmes disa masave ndihmuese të cilat kanë pasur target kategoritë më të cënueshme dhe më të prekura nga kjo krizë. Në Kosovë, masat në fjalë, përveç që kanë pasur objektivë ringjalljen ekonomike, kanë pasur për qëllim edhe adresimin e disa problemeve tashmë të bëra mënyrë e të jetuarit në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe në Kosovë janë miratuar dhe implementuar disa pako që kanë pasur për qëllim ndihma socio-ekonomike. Pakoja e parë e miratuar ishte Pako Emergjente Fiskale e miratuar në muajin mars të vitit 2020, duke vazhduar me Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, e cila u miratua në muajin dhjetor të vitit 2020 dhe pakoja e fundit e quajtur Pako e Ringjalljes Ekonomike që u miratua në muajin korrik të vitit 2021.

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, konsiderohet një ndër pakot me rëndësi dhe vlerë më të madhe nga ky varg pakosh. Përveç rëndësisë për mirëqenien ekonomike dhe sociale, pakoja gjithashtu ka të alokuar shumë prej 420 milionë euro, që bën kështu Pakon e Ringjalljes Ekonomike, pakon me vlerën më të lartë financiare. Pakoja e Ringjalljes ka për objektivë fuqizimin e gruas në ekonomi, formalizimin e ekonomisë, shtrimin e mundësive të reja ekonomike për të rinjtë, rritje e bruto produktit vendor duke favorizuar sektorët prodhues, rritjen e përgjithshme ekonomike, përmirësimin e mirëqenies e indikatorë të tjerë të prekur nga masat e kësaj pakoje. Përkundër kësaj, nuk duhet lënë anash as rëndësinë e pakove tjera të cilat kanë kontribuar në zbutjen e pasojave pas pandemike si dhe njëkohësisht rritjes së mirëqenies socio-ekonomike. Gjithsej shuma e të hollave e ndarë për implementimin e të gjitha pakove është 820.65 milionë euro.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri”, projekt i cili mbështetet Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID-i, ka analizuar dhe monitoruar procesin e implementimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, në faza periodike, dhe ende vazhdon të bëjë këtë. Procesi i analizës dhe monitorimit bëhet në mënyra të ndryshme, përmes raporteve monitoruese dhe infografikave. Ky raport i rradhës, është raporti i dytë monitorues i Pakos së Ringjalljes. Raporti i dytë i monitorimit është fokusuar përsëri në të dhënat e marra nga Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Administrata Tatimore e Kosovës e insitucione të tjera përgjegjëse.

Raporti i dytë i monitorimit është i realizuar në kuadër të procesit të monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, dhe është përpiluar duke monitoruar periudhën *dhjetor-shtator* të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes. Në përgjithësi, procesi i monitorimit përfshin edhe publikimin e

buletineve të cilët deri tani kanë arritur shifrën 7, gjithsej 12 infografikave informuese, 3 podkastëve dhe 2 diskutimeve live me akterë të rëndësishëm me të cilët analizohet Pakoja e Ringjalljes dhe gjendja aktuale post-pandemike. Të gjitha këto aktivitete kanë për qëllim informimin e qytetarëve rreth masave ndihmëse të Pakos si dhe zbatimit të saj. Këto aktivitete të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) tentojnë që të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, e në të njëjtën kohë të mbajnë të informuar qytetarët rreth masave dhe përfitimeve që kanë ata ndaj Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti të monitorimit është përdorur metodologji e përzier që përmban metodën kërkimore cilësore dhe sasore. Për përpilimin e këtij raporti u punua duke u përdorur metoda kërkimore cilësore, duke konsultuar dokumente përkatëse dhe duke mbledhur të dhëna dhe informata në burime të ndryshme, rreth zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Krahas kësaj në mënyrë që ky raport të jetë sa më i plotë, INDEP ka plotësuar gamën e informatave cilësore edhe përmes kërkimit sasior. Gjatë procesit të përpilimit të raportit, INDEP ka organizuar takime dhe diskutime gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve, entiteteve ekonomike dhe akterëve të tjerë relevantë, në mënyrë që të marrë informata të sakta dhe koherente për zbatimin e Pakos së Ringjalljes. INDEP gjithashtu ka përdorur metodën e vëzhgimit për të vlerësuar procesin e zbatimit, për të parë nga afër atë dhe për të vështruar sjelljen e akterëve zbatues përgjatë një kohështirje prej katër muajve.

Pas mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave ka kaluar në dy faza kryesore. Në fazën e parë, INDEP ka sistemuar të dhënat dhe ka bërë një analizë të përmbajtjes. Në pjesën e dytë, është bërë tabulimi i të dhënave nga kërkimi cilësor me përfundimet e nxjerra nga intervistat për të nxjerrë qëndrimet përfundimtare. Në fund, raporti ka kaluar edhe nëpër një analizë të përgjithshme të kontekstit zhvillimor të Kosovës ku edhe është përshkallëzuar niveli i zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Shkallëzimi i nivelit të zbatimit të masave është ndarë në katër nivele. Këto nivele janë:

1. Pa zbatim

Masa nuk ka filluar funksionalizimin dhe INDEP nuk ka gjetur të dhëna që masa ka filluar të implementohet

2. Zbatim i kufizuar

Masa është funksionalizuar por INDEP nuk ka gjetur të dhëna që masa ka filluar të implementohet

3. Zbatim i pjesshëm

Masa është funksionalizuar dhe INDEP ka gjetur të dhëna që masa është duke u implementuar

4. Zbatim i plotë

Masa është funksionalizuar dhe INDEP ka gjetur të dhëna që masa është implementuar plotësisht

Përmes këtij shkallëzimi do të paraqesim nivelin e zbatimit aktual të masave që përmban kjo pako e ndihmave ekonomike.

Të dhënat e këtij raporti janë marrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës. Këto të dhëna ndihmojnë në krahasimin dhe përcaktimin e nivelit të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Përmes këtyre të dhënave, INDEP synon informimin e qytetarëve dhe akterëve relevantë mbi procesin e implementimit të Pakos së Ringjalljes.

Përmbledhje e përgjithshme sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike

Menjëherë pas miratimit të Pakos së Ringjalljes, Qeveria e Kosovës ka filluar zbatimin e masave të së njëjtës Pako. Pakoja e Ringjalljes ka për qëllim zbutjen e pasojave ekonomike dhe sociale, të shkaktuara nga Pandemia Covid-19, dhe njëkohësisht rritjen e mirëqenies. Pakoja ka gjithsej 5 masa, nën të cilat përfshihen 3-7 nënmasa ndihmëse, të cilat kanë të paraparë mbështetje për ringjalljen dhe formalizimin e ekonomisë, punësimin, prodhimin, arsimin, shëndetësinë, skemat sociale, ndërmarrjet publike. Qeveria ka alokuar mjete financiare prej gjithsej 420 milionë euro për Pakon e Ringjalljes, duke pasur në fokus zbutjen e pasojave socio-ekonomike për kategoritë më të cenueshme dhe të prekura nga pandemia.

MFPT e cila është përgjegjëse kryesore për përpilimin e masave ndihmëse të Pakos së Ringjalljes Ekonomike ka bashkëpunuar me akterë të ndryshëm institucional për procesin e përpilimit dhe tanimë po bashkëpunon edhe në procesin e zbatimit të saj. Akterë të tjerë që janë të përfshirë në procesin e përpilimit dhe zbatimit të Pakos së Ringjalljes janë MASHT, MKRS, MSH, ATK. Këta akterë kanë pasur përgjegjësi për përpilimin dhe zbatimin e masave dhe nën-masave specifike të kësaj Pakoje, por gjithsesi barra kryesore e përgjegjësisë për zbatimin e duhur të Pakos bie mbi Qeverinë e Kosovës, saktësisht MFPT-në.

Pakoja e Ringjalljes përmban pesë masa kryesore për zbatimin e të cilave janë ndarë mjete financiare në vlerë prej 420 milionë euro. Prej këtyre 190 milionë euro janë të financuar përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prej 230 milionë Euro janë financuar përmes huamarrjes. Me miratimin e mjeteve financiare të alokuara për Pakon e Ringjalljes, për të cilat mjete u rishikua buxheti i vitit 2021 u bë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 07/ L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike¹. Përtej kësaj, Pako e Ringjalljes vazhdon të zbatohet edhe në vitin 2022. Vlen të përmendet se të buxhetuara në mënyrë të përhershme janë disa nga nënmasat e pakove. Edhe pse në ndarjen buxhetore të vitit 2022, nuk është e buxhetuar shuma totale me të cilat është deklaruar se do të mbështet i gjithë zbatimi i masave, janë të buxhetuara disa masa në mënyrë direkte dhe disa të tjera tashmë të integruara nën skemat e politikave sociale të Qeverisë.

¹ Për një pasqyrë narrative të detajizuar, të procesit të miratimit të Pakos dhe rishikimit të buxhetit për vitin 2021 për qëllim alokimin e mjeteve financiare për Pakon e Ringjalljes, shih [Raportin e Monitorimit 1](#).

Vlen të theksohet se gjatë procesit të përpilimit të masave ndihmëse të Pakos së Ringjalljes, Qeveria si përgjegjëse kryesore për Pakon, nuk ka mbajtur konsultime publike, të cilat konsiderohen të domosdoshme në rastet kur një iniciativë e tillë merr formë reale. Konsultimi me qytetarët, shoqërinë civile e institucionet tjera të pavarura konsiderohet tepër e nevojshme në raste të tilla duke qenë se ky projekt ka rëndësi të madhe për qytetarët dhe është mjaft e kushtueshme. Përfshirja e palëve të treta në cdo iniciativë të Qeverisë konsiderohet jetike dhe e nevojshme për rritje të llogaridhënies dhe transparencës. Duke qenë se platforma digjitale për konsultime publike ekziston dhe është shumë funksionale, mos-përdorimi i saj në raste kur miratohen dhe implementohen projekte në përmasa kaq të mëdha konsiderohet lëshim dhe neglizhencë e thellë nga ana e Qeverisë.

Problemin e thellon edhe më shumë fakti që sipas Rregullores 05/2016², qeveria e ka të obligueshme të vendos çdo projekt-propozim apo draft-ligj në platformën digjitale për konsultime publike. Kjo sepse pjesëmarrja e palëve të treta si shoqëria civile dhe qytetarët apo institucione të tjera të pavarura në procese kaq të rëndësishme politikbërëse përveç që rrit llogaridhënien dhe transparencën është me interes të madh edhe për vetë Qeverinë. Kjo për faktin se Qeveria ndihmon dhe përafron nismat e ndryshme duke u bazuar në probleme reale dhe duke dëgjuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, si dhe përfiton nga ekspertiza të jashtme që vijnë nga palë të treta si shoqëria civile, entitetet ekonomike, të cilat nuk duhet të nënvlerësohen asnjëherë e aq më pak në këto kohë dhe kushte të vështira.

Raporti i Zbatimit

Masa 1 - Mbështetja e Punësimit

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike ka shuma të ndara për secilën masë dhe nën-masë. Për masën e parë të quajtur ‘Mbështetja e Punësimit’, janë ndarë gjithsej 50 milionë euro. Kjo masë ka pasur në fokus të saj punësimin dhe formalizimin e ekonomisë. Kjo masë kishte për qëllim rritjen e numrit të punësuarve duke parë se sidomos pas periudhës së pandemisë situata në raport me numrin e të punësuarve e cila veç ishte në gjendje të keqe, u përkeqësua edhe më shumë. Vlerë e shtuar e masës është se u orientua kryesisht drejtë fuqizimit të grave dhe të rinjve, por duke ndikuar në të njëjtën kohë edhe në formalizimin e ekonomisë. Masa e parë pati të përfshirë mbështetje për këto grupe:

1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë
2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar
3. Mbështetja e punësimit të grave
4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë
5. Trajnimi dhe punësimi në TI
6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta
7. Skema e granteve për zanatet

² Rregullore NR. 05/2016 PËR STANDARDET MINIMALE PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, Gazeta Zyrtare, 13.05.2016, Prishtinë, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>, (qasur në shkurt, 2022)

Kjo masë mbështetëse e Pakos së Ringjalljes pati për objektive kryesore krijimin e vendeve të reja të punës, e orientuar nga fuqizimi i grave dhe të rinjve. Formalizimi i ekonomisë ishte objektiv tjetër i synuar me zbatimin e masave, duke pasur parasysh që sipas studimeve të shumta vlerësohet që Kosova të ketë të operacionalizuar ekonominë ndërmjet 26.67% deri në 34.75%³. Padyshim që kjo masë është një stimul i mirë për ndërmarrësit që të fillojnë të deklarojnë aktivitetet e tyre ekonomike dhe njëkohësisht të rritet besimi i punëtorëve në entitete ekonomike. Kështu ju dha mbështetje punëtorëve të ripunësuar, grave si dhe punëtorëve të rinj të punësuar në këto kohë pandemike, me incentiva financiare të konsiderueshme. Masa 1 pati në fokus edhe ngritjen e kapaciteteve të të rinjve në fushën e TI-së, dhe masat konsiderohen mjaftueshëm inicuese dhe mbështetëse, nëse zbatohen në plotëni për pjesën e të rinjve të cilët janë të orientuar drejtë teknologjisë së informacionit, si dhe për të rinjtë apo të tjerë të cilët kanë synime drejtë aftësimi profesional. Të punësuarit me nevoja të veçanta patën mbështetjen e tyre duke u bazuar në masat e Pakos, megjithatë mbetet të monitorohet zbatimi i të gjitha masave.

Niveli i Zbatimit

Pakoja e Ringjalljes po vazhdon ende me zbatimin e masave të saj, masa që filluan operacionalizimin me datë 30 qershor, 2021. Për tri masat e para të Pakos që u përpiluan dhe zbatuan nën përgjegjësinë e Administratës Tatimore të Kosovës dhe filluan zbatimin në muajt korrik-gusht, u konsiderua që zbatimi gati ishte përfunduar në plotëni, për shkak se aplikimi tashmë është mbyllur, dhe përfitues të ri nuk mund të ketë më.⁴ Me këtë rast, MFPT publikoj në nëntor të vitit 2021, të dhëna të cilat njoftuan publikun se numri i përfituesve që kanë përfituar nga këto masa është si në vijim:




Figura 1. Niveli i zbatimit të masës 'Mbështetja për familjen'

Masa 1.1 – 667 përfitues

Masa 1.2 – 3,134 përfitues

Masa 1.3 – 1,939 përfitues

Përkundër shifrave të publikuara në këtë periudhë kohe, në shkurt të vitit 2022, Qeveria e Kosovës ndau mjete financiare prej 3.5 milionë euro për vazhdimin e zbatimit të disa prej masave. Një ndër masat për të cilat u vendos të vazhdohet zbatimi janë nënmasat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5⁵. Për masën 1.1, 1.2 dhe 1.3 u ndanë gjithsej 1 milionë euro nga kjo shumë e aprovuar në shkurt, 2021, ndërsa

³Analiza e Ekonomisë në hije në Kosovë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2019, Prishtinë i qasshëm këtu http://www.ashak.org/repository/docs/Analiza_e_ekonomise_ne_hije_ne_Kosove_529729.pdf (qasur në shkurt, 2022)

⁴ Për të lexuar monitorimin e zbatimit të masave 1.1, 1.2, 1.3 gjatë periudhës shtator- nëntor, shih [Raportin Monitorimit 1](#)

⁵ Vendimi 09/62 i Qeverisë së Kosovës; Gazeta Zyrtare; 23.02.2022; Prishtinë, i qasshëm këtu: <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (qasur në shkurt, 2022)

për nënmasën 1.5 u nda shuma prej 500 mijë euro. Këto mjete financiare janë alokuar për masat për të cilat tashmë është mbyllur aplikimi, rrjedhimisht masat 1.1, 1.2 dhe 1.3. Gjithsesi, edhe pse nuk ka pasur arsyetim zyrtar nga Qeveria, por këto mjete mund të jenë alokuar për arsye të mosshpërndarjes të subvencioneve tek të gjithë aplikuesit. Për më tepër në kuadër të kësaj mase është lansuar edhe aplikacion elektronik për verifikimin e punëtorëve, me të cilën punëtorët mund të verifikojnë a janë të regjistruar apo jo, dhe mund të raportojnë punëdhënësin në rast se verifikojnë që nuk janë. Kjo, gjithsesi që ka për qëllim zbutjen e ekonomisë jo formale, objektiv i të cilës masë konsiderohet ky mjet. Pas miratimit të kërkesës nga MFPT, Qeveria e Kosovës alokoj mjete financiare edhe për masa të tjera të përmendura më poshtë.

Një ndër masat tjera që filloj zbatimin në nëntor ishte masa 1.4, përkatësisht skema e garantuar për punësim të të rinjve. Në kuadër të kësaj nën-mase, MFPT në bashkëpunim me APRK kanë krijuar programe praktike për punësimin e 150 studentëve të diplomuar në UP, për mundësinë e punësimit në të njëjtin universitet, sigurisht me plotësimin e disa kritereve paraprake për studentët. Të njëjtin program praktike MFPT e ka krijuar edhe me ATK, duke nënshkruar kështu Marrëveshje Bashkëpunimi për punësimin e 100 të rinjve profesional në afat kohor 6 muaj me pagë bruto prej 340 euro⁶. Aplikimet për këto programe praktike tashmë janë mbyllur, por ende nuk ka të dhëna zyrtare mbi fillimin e punës së të rinjve të përzgjedhur për pjesëmarrje në program. Kjo mund të vijë edhe nga fakti se njëri nga programet ka mbyllur aplikimet në fund të dhjetorit.

Sa i përket nënmasës së radhës ‘Trajnimi dhe punësimi në TI’, e cila sipas Pakos së Ringjalljes dhe MFPT ka të alokuar mjete financiare prej shumës 5 milionë euro, ende nuk ka filluar zbatim i mirëfilltë i saj. Për më tepër sipas vendimit të Qeverisë të datës 23 shkurt, 500 mijë euro janë ndarë nga buxheti i vitit 2022 të Republikës së Kosovës për këtë masë.⁷ Janë hapur programe aplikimi për ndarjen e 2,000 kuponëve me vlerë deri në 600 euro për të ndjekur trajnime në fushën e TI-së, përmes kompanisë për shërbime financiare FINAKON, por ende nuk ka të dhëna nëse ka filluar shpërndarja e këtyre kuponëve apo jo. Kjo vlen edhe për dy nënmasat tjera 1.6 ‘Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta’ dhe nënmasa 1.7 ‘Skema e granteve për zanatet’, të cilat kapin shifrën prej 10 milionë euro për zbatimin e tyre. Ende nuk ka të dhëna për nisjen e zbatimit të tyre, madje as në nivel minimal, e kjo konsiderohet shqetësuese marrë parasysh faktin se grupet e cenueshme të nënmasave në fjalë, ende nuk kanë marrë ndihmë shtetërore post-pandemike.

Tabela 1. Niveli i zbatueshmërisë për masën 1

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit dhe janë ekzekutuar të gjitha, si dhe janë alokuar mjete të reja financiare prej 1 mil. Euro për vazhdimin e zbatimit të saj.

⁶Aplikimi për programin e praktikës, në ATK, i qasshëm në [https://apr.krk.gov.net/Content/News/Detail?ide=TND7hs\(05xzlqozx1vU6BQ%3D%3D](https://apr.krk.gov.net/Content/News/Detail?ide=TND7hs(05xzlqozx1vU6BQ%3D%3D)

⁷Vendimi 09/62 i Qeverisë së Kosovës; Gazeta Zyrtare; 23.02.2022; Prishtinë, i qasshëm këtu: <https://gzk.krk.gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (qasur në shkurt, 2022)

		(Kjo shumë përfshin edhe nënmasën 1.2 dhe 1.3)
Mbështetja për të punësuarit e formalizuar	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit dhe ekzekutimi i tyre. Poashtu janë alokuar mjete të reja financiare prej 1 mil. Euro për vazhdimin e zbatimit të saj. (Kjo shumë përfshin edhe nënmasën 1.1 dhe 1.3)
Mbështetja e punësimit të grave	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit si dhe ekzekutimi i tyre. Poashtu janë alokuar mjete të reja financiare prej 1 mil. Euro për vazhdimin e zbatimit të saj. (Kjo shumë përfshin edhe nënmasën 1.1 dhe 1.2)
Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe janë hapur aplikimet e para për punë praktike me pagesë për gjithsej 250 të rinjë profesional.
Trajnimi dhe punësimi në TI	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe deri më tani janë ndarë 5 milionë e 500 mijë euro.
Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta	Pa zbatim	Masa nuk ka filluar ende zbatimin dhe rrjedhimisht nuk është operacionalizuar ende.
Skema e granteve për zanatet	Pa zbatim	Masa nuk ka filluar ende zbatimin dhe rrjedhimisht nuk është operacionalizuar ende.

Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

Padyshim që një krizë globale si pandemia COVID-19 la pasoja të mëdha edhe në ekonomi. Pasojat e shkaktuara patën një impakt të madh afatshkurtër dhe afatgjatë, duke prekur kështu mirëqenien e secilit. Për shkak të këtij impakti negativ u bë e domosdoshme që shtetet të ndërhyjnë për të minimizuar efektet zingjyrore që pandemia shkaktoj globalisht. Njëjtë edhe në Kosovë, u krijuan pako ekonomike për të parandaluar një kollaps ekonomik. Pakoja e Ringjalljes e cila është momentalisht duke u zbatuar përfshin edhe nënmasën 'Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit' e cila ka për qëllim t'i japë shtysë ekonomisë vendore duke përmirësuar strukturën e përbërjes së PBB-së, kryesisht në sektorët e prodhimit. Për të pasur efekt gjithëpërfshirës, duhet mbështetur edhe entitetet ekonomike, të prekura nga pandemia. Për këtë arsye fillimisht për këtë masë u ndanë 108 milionë euro. Patjetër që ringjallja e ekonomisë do të duhej bërë duke ndryshuar paternet e vjetra të punës dhe duke u orientuar nga një e ardhme e gjelbër. Masa ka për qëllim zvogëlimin e pasojave përmes këtyre ndërhyrjeve:

1. Subvencionimi i kredive investive
2. Mbështetje bizneseve për qasje në financa
3. Investime në TI dhe Inovacion
4. Mbështetja e Eksportit
5. Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit
6. Rikuperimi i hotelarisë dhe bizneseve të mbyllura

Niveli i Zbatimit

Në tre mujorëshin e dytë të monitorimit të zbatimit të Pakos së Ringjalljes, masa 2 ende mbetet pjesërisht e zbatuar. Nënmasa e parë ka filluar zbatimin e kufizuar ku parat e mbledhura nga Bonot e Diasporës, e që gjithsej janë 10.43 milionë Euro, janë alokuar për subvencionimin e kredive investuese të bizneseve prodhuese e përpunuese. Kjo nënmasë ka për qëllim mbështetjen për sektorin prodhues të vendit, konkretisht ndihmën e ndërmarrjeve prodhuese me kredi investive të cilat jepen specifikisht për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe prodhuese brenda kompanisë⁸.

Zbatueshmëria e nënmasës mbetet ende i kufizuar për arsye se aplikimi për këto kredi do të mbetet i hapur deri në qershor të vitit 2022. Për zbatimin e kësaj mase ka pasur polemika dhe kundërshtime nga ana e ndërmarrjeve prodhuese. Madje është konsideruar selektive për faktin se mbështet




Figura 2. Niveli i zbatimit të masës 'Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit'

ndërmarrjet prodhuese në afate kufizuese kohore, duke mos pasur parasysh periudhën fillestare të pandemisë. Kjo për faktin se entitetet e tilla mund të subvencionohen vetëm në rast se kanë aplikuar për kredi të llojit të tillë prej tetorit të vitit 2021. Një gjetje tjetër e INDEP-it gjatë monitorimit të procesit të zbatimit të Pakos, është se mjetet financiare prej 10 milionë e 430 mijë euro janë transferuar nga kjo nënmasë për tu shpenzuar në mënyra tjera. Kjo bjen te përfundimi se tashmë për zbatimin e masës janë në dispozicion vetëm 20 milionë euro, duke përfshirë këtu paratë e mbledhura nga Bonot e Diasporës, meqenëse nuk ka deklarata

zyrtare që këto para janë transferuar për t'u përdorur për nevoja tjera financiare.

Nënmasa 2.4 'Mbështetja e Eksportit' lidhet direkt me nënmasën 2.1, për shkak se ka për qëllim mbështetjen financiare për ndërmarrjet prodhuese, duke subvencionuar ngritjen e kapaciteteve të stafit menaxherial për certifikim profesional, marketing si dhe pjesëmarrje në trajnime jashtë vendit për mundësinë e gjetjes të tregjeve të reja. Kjo nënmasë u prezantua nga MFPT në të njëjtën kohë me masën 2.1, por ende mbeten vetëm në fazën e parë të operacionalizimit të saj. Poashtu, nënmasa 2.2 'Mbështetje bizneseve për qasje në financa' mbetet ende e zbatuar në mënyrë të

⁸Vendimi 66/2021 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 28.10.2021, Prishtinë, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/7095D9A9-25D7-4FB5-97AD-8EEFF4EDC1C9.pdf> (e qasur në shkurt, 2022)

kufizuar. Përveç mbështetjes të tarifave të garancisë me 3 milionë euro të FKGGK-së⁹, pjesa e shumës tjetër të premtuar nga Pako mbetet ende pa u vënë në zbatim. Për më tepër duhet të përmendet se Qeveria e Kosovës ka alokuar mjete financiare për nënmasën 2.5 ‘Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit’ prej 2 milionë e 500 mijë euro¹⁰, por ende nuk ka filluar operacionalizimi i kësaj nënmasë. Kështu ka ndodhur edhe me nënmasat tjera, për të cilat ende nuk ka të dhëna zyrtare nëse është duke u përgatitur fillimi i operacionalizimit të tyre apo jo.

Tabela 2. Niveli i zbatueshmërisë për masën 2

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Subvencionimi i kredive investive	Zbatim i kufizuar	Masa është operacionalizuar dhe është hapur afati për aplikim për subvencionim.
Mbështetje bizneseve për qasje në financa	Zbatim i pjesshëm	Masa ka filluar të zbatohet dhe janë ndarë 3 milionë Euro për zbatim të plotë të saj.
Investime në TI dhe Inovacion	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Mbështetja e Eksportit	Zbatim i kufizuar	Masa është operacionalizuar dhe është hapur afati për aplikim për subvencionim.
Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit	Zbatim i pjesshëm	Masa ka filluar të zbatohet dhe janë ndarë mjete financiare prej 2 milionë e 500 mijë euro.
Rikuperimi i hotelarisë dhe bizneseve të mbyllura	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.

Masa 3 - Mbështetja për familjen

Për shkak të pandemisë COVID-19, globalisht shoqëritë e komunitetet pësuan tronditje dhe patën regres, duke ndikuar kështu në rritjen e varfërisë, pabarazive, diskriminimit e plot dukurive negative. Shoqëritë kosovare patën gjithashtu shkundje dhe sulme të forta, të cilët prekën mirëqenien e tyre në thelb. Padyshim që pas një krize të tillë humane e shëndetësore, dimensionin social mori vëmendje të vecantë dhe qeveritë globalisht u përgatitën për përgjigje të shpejtë në këtë drejtim. Jo ndryshe nga qeveritë tjera, Qeveria e Kosovës mori masa mbështetëse që prekin dimensionin social, duke inkuadruar ato në pakot për rimëkëmbje ekonomike dhe sociale. Pakoja e Ringjalljes që po zbatohet aktualisht përfshin disa masa mbështetëse për shoqërinë nën të cilën janë të alokuara mjete financiare prej 50 milionë euro. Kjo shumë fillimisht u planifikua të shpërndahet në gjashtë nënmasa. Në shkurt të këtij viti, Qeveria shtoi dy nënmasa të tjera të cilat do të elaborohen më poshtë. Nënmasat janë si në vijim:

⁹ Lajme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 11.08.2021, Prishtinë e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1111>, (qasur në shkurt, 2022)

¹⁰Vendim 20/50 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 23.12.2021, Prishtinë i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (qasur në shkurt, 2022)

1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin
2. Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale
3. Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale
4. Kuponë ushqimi për familjet në nevojë
5. Pagesa për lehonat e papuna
6. Mbështetja e likuiditetit familjar
7. Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike
8. Rritja e rezervave shtetërore

Niveli i Zbatimit

Meqenëse masa e tretë është me prioritet të veçantë, është trajtuar më seriozisht nga Qeveria e Kosovës. Ky trajtim i tillë ka ndikuar në operacionalizimin e gati të gjitha nënmasave, të paktën deri në një masë të caktuar, ndryshe nga masat e tjera. Nënmasa 3.1 ‘Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin’, është ende e pazbatuar në plotëni. Kjo për faktin se rastet e vdekjes për shkak të pandemisë COVID-19 janë ende aktive. Megjithatë duhet të përmendet se aplikimi për grupin e parë është mbyllur dhe pagesat janë ekzekutuar, dhe ende nuk është hapur aplikim i ri për grupet tjera të cilat kanë përjetuar rast vdekje në periudhën pas mbylljes së aplikimit. Ndërsa, sa i përket masës 3.2, përtej alokimeve të mjeteve financiare për vitin 2021, si dhe shtesave të aplikuara gjatë periudhës tre mujore të kaluar, vlen të përmendet se skema pensionale do të vazhdojë të zbatohet, si dhe shtesat për pensionerë tash janë bërë të përhershme. Pra që nga viti 2022 asnjë shtesë pensionale nuk do të jetë nën vlerën 100 euro. E njëjta vlen edhe sa i përket shtesave për familjet me asistencë sociale, duke nënkuptuar kështu që masa është zbatuar në tërësi.

Nënmasa 3.3 është në fillim të zbatimit, kjo për faktin se në dhjetor është nënshkruar marrëveshje e financimit për ‘Projektin e Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë’ në mes të MFPT dhe Bankës Botërore¹¹. Marrëveshja premton mjete financiare në vlerë prej 45 milionë euro që do të orientohen drejtë përmirësimit të performancës së Skemës së Ndhmës Sociale. Ende nuk ka të dhëna zyrtare kur do të konkretizohet marrëveshja dhe kur do të fillojnë të përfitojnë kategoritë që nënmasa përfshin. Nënmasa 3.4 e emëruar ‘Kuponë ushqimi për familjet në nevojë’ është nënmasë e cila është zbatuar tërësisht.

¹¹ Lajme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, 26.10.2021, Prishtinë e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1141> (qasur në shkurt, 2022)

'Pagesa për lehonat e papuna' është nënmasa e pestë e masës së tretë Pakos, përmes së cilës synohet të fuqizohet gruaja dhe pozita financiare e saj. Kjo nënmasë është zbatuar në vitin 2021 plotësisht, duke qenë se aplikimi është bërë cdo muaj dhe pagesat janë ekzekutuar.¹² Nënmasa vazhdon të zbatohet ende, si dhe në planifikimin buxhetor të vitit 2022 parashihet që kjo mbështetje financiare të vazhdojë të aplikohet të paktën deri në vitin 2024.¹³ Nënmasa 3.6 synon mbështetjen e likuiditetit familjar, dhe ka synim subvencionimin e kredive për konsum. Kjo nënmasë ka filluar zbatimin e saj, duke hapur aplikimin për kredi konsumuese me subvencion 10% të kredisë, deri në shumën 10.000 euro. Deri tani është bërë ekzekutimi i pagesave për 3,396 përfitues të kësaj mase, dhe nuk ka të dhëna zyrtare nëse ky subvencionim do të vazhdojë edhe në vitin 2022, por duke marrë parasysh se 23 dhjetor janë alokuar edhe mjete të tjera financiare në vlerë 6 milionë euro për zbatimin e kësaj nënmasë, pritet vazhdimi i zbatimit të saj edhe për subvencionimin e aplikuesve të tjerë.¹⁴




Figura 3. Niveli i zbatimit të masës 'Mbështetja për familjen'

Qeveria e Kosovës ka miratuar dy nënmasa të reja për tejkalimin e krizës nga pasojat ekonomike të Pandemisë COVID-19. Për zbatimin e nënmasës 3.7 janë ndarë mjete buxhetore në vlerë 20 milionë euro. Kjo nënmasë do të zbatohet nga Ministria e Ekonomisë e cila do të transferojë këtë shumë parash të KEK për subvencionimin e importit të energjisë elektrike. Për rritjen e rezervave shtetërore që bie nën nënmasën 3.8 janë ndarë gjithsej mjete financiare prej 10 milionë euro.¹⁵ Këto mjete janë transferuar te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e cila do të zbatojë këtë masë në koordinim me MFPT.

Tabela 3. Niveli i zbatueshmërisë për masën 3

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka filluar të zbatohet. Tashmë është ekzekutuar pagesa për rreth 3,396 familje që kanë humbur familjarin si pasojë e pandemisë COVID-19.

¹² Vendimi 54/2021 i Qeverisë e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 08.09.2021, Prishtinë, i qasshëm në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4F250604-F09F-481F-B678-EB53F7BE9BEF.pdf> (Qasur në shkurt, 2022)

¹³ Ligji 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Gazeta Zyrtare, dhjetor 2021, Prishtinë i qasshëm në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791B0ADE3337.pdf> (qasur në shkurt, 2022)

¹⁴ Vendimi nr. 19/50 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 23.12.2020, Prishtinë, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (Qasur në shkurt, 2022)

¹⁵ Vendimi 01/65 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 26.02.2022, Prishtinë i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (Qasur në shkurt, 2022)

Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale	Zbatim i plotë	Kjo mbështetje financiare është bërë e përhershme.
Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale	Zbatim i kufizuar	Në kuadër të kësaj nënmasë është bërë marrëveshje me Bankën Botërore, sidoqoftë masa ende është në fillim të zbatimit.
Kuponë ushqimi për familjet në nevojë	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe tashmë është mbyllur afati për aplikim. Përmes saj është tentuar mbështetje për kuzhinat popullore për personat në nevojë. MTFP ka nënshkruar marrëveshjet e mbështetjes financiare me përfaqësuesit e organizatave përfituese.
Pagesa për lehonat e papuna	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka filluar edhe zbatimi i pagesave për përfituesit. Masa është e buxhetuar për zbatim deri në vitin 2024.
Mbështetja e likuiditetit familjar	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe është hapur aplikimi për kredi konsumuese. Deri tanë janë ekzekutuar pagesa për 3,396 persona, si dhe janë alokuar mjete të tjera financiare në vlerë prej 6 milionë euro.
Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike	Zbatim i plotë	Janë ndarë mjete buxhetore në vlerë 20 milionë euro. Kjo nënmasë do të zbatohet nga ME cila do të transferojë këtë shumë parash te KEK për subvencionimin e importit të energjisë elektrike.
Rritja e rezervave shtetërore	Zbatim i plotë	Për këtë masë janë ndarje mjete financiare prej 10 milionë euro. Këto mjete janë transferuar te MINT e cila do të zbatojë këtë masë në koordinim me MFPT.

Masa 4 - Mbështetja për publikën

Mbështetja për publikën apo masa e katërt e Pakos së Ringjalljes Ekonomike ka gjithsej të alokuar mjete financiare në vlerë 112 milionë euro. Zbatimi i suksesshëm dhe i plotë i masës ka synim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, duke ndihmuar edhe këndelljen nga pasojat pandemike për sektorët e listuar më poshtë. Masa ka vlerë të veçantë për arsye që përfshin edhe ndihmën e diasporës shqiptare. Nënmasat përfshijnë mbështetje për sektorët të listuar në vijim:

1. Mbështetja për shëndetësinë
2. Mbështetja për arsimin

3. Mbështetja e Kulturës dhe Sportit
4. Mbështetja e sigurisë
5. Mbështetja e mërgatës
6. Mbështetja e ndërmarrjeve publike

Niveli i Zbatimit

Në tremujorëshin e procesit të monitorimit të Pakos së Ringjalljes për periudhën Nëntor - Shkurt është analizuar edhe nënmasa e radhës e për të cilën buxheti fillestar i alokuar ishte 112 milionë euro. Nënmasa e parë e kësaj mase ‘Mbështetja për Shëndetësinë’ ende nuk është zbatuar plotësisht. Në raportin e monitorimit të periudhës tre mujore shtator-nëntor u analizua shpërndarja e mjeteve financiare prej 2.7 milionë euro për këtë nënmasë¹⁶ e cila shpiu në një nivel të zbatimit të pjesëshëm të masës. Gjithsesi në këtë tre mujor të dytë, u alokuan fonde të tjera prej 3 milionë euro, për vazhdimin e zbatimit të saj.

Sa i përket nënmasës së dytë të kësaj mase, në dhjetor të vitit 2021 u ndërmorr vendimi për ndarjen e shumës prej 4 milionë e 110 mijë euro edhe për nënmasën 4.2 e cila përfshin mbështetjen financiare për arsimin. Përveç vendimit të marrë për shpërndarjen e mjeteve, ende nuk ka të dhëna zyrtare nëse kjo masë ka filluar të zbatohet dhe të realizohen objektivat e synuara përmes zbatimit të saj. Duhet të përmendet se nënmasa 4.3 dhe 4.5 janë tashmë të zbatuara gati në plotëni, duke marrë parasysh se fondet për këto masa janë alokuar ashtu sic është synuar në Pakon e Ringjalljes, si dhe fondet e ndara për nënmasën 4.5 kanë reduktuar kostot e policës kufitare për të gjithë mërgimtarët që vijnë në Kosovë. Më 23 dhjetor në mbledhjen e Qeverisë u miratua gjithashtu edhe vendimi për alokimin e fondeve në vlerë prej 2 milionë e 400 mijë euro për vazhdimin e zbatimit të kësaj mase edhe në vijim. Sa i përket nënmasës 4.4 ‘Mbështetja e Sigurisë’, nuk ka të dhëna zyrtare, dhe vendim të qeverisë në lidhje me fillimin e zbatimit të saj. Për këtë arsye kjo nënmasë konsiderohet ende e pazbatuar.




Figura 4. Niveli i zbatimit të masës 'Mbështetja për Publikën'

‘Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike’ e renditur nën numrin 6 të masës së 4, ka filluar gjithashtu zbatimin e saj. Qeveria ka ndarë mjete financiare në shumën 10 milionë e 860 mijë euro për të mbështetur financiarisht ndërmarrjet publike.¹⁷ Nga zbatimi i masës në fjalë përfitojnë ndërmarrjet publike qëndrore dhe lokale që kanë vështirësi financiare, si pasojë e përbaljes me pandeminë.

¹⁶ Raport i monitorimit i zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Qeverisë, INDEP, Dhjetor 2021, Prishtinë i qasshëm në https://indep.info/wp-content/uploads/2021/12/BTD_INDEP-Raporti-i-Monitorimit_ALB.pdf, (qasur në shkurt, 2022)

¹⁷ Vendim nr. 01/53 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 31.12.2021, Prishtinë i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (qasur në shkurt, 2022)

Ndërmarrjet publike do të kenë mundësinë e huamarrjes me kthim pa interes, për të përballuar kështu shpenzimet operative dhe mbulimin e obligimeve financiare. Ndërmarrjet që do të mbështeten janë Trepça Sh.A dhe Telekom Sh.A, të cilat rrezikojnë humbjen e licensës së punës, në rast të mos mbulimit të obligimeve financiare që ato kanë.

Tabela 4. Niveli i zbatueshmërisë për masën 4

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Mbështetja për shëndetësinë	Zbatim i pjesshëm	Janë ndarë 3 milionë Euro për vazhdimin e zbatimit të kësaj mase.
Mbështetja për arsimin	Zbatim i pjesshëm	Janë ndarë mjete financiare 4 milionë e 110 mijë euro për mbështetjen financiare për arsimin
Mbështetja e Kulturës dhe Sportit	Zbatim i plotë	Janë ndarë 5 milionë Euro për këtë masë si mbështetje ndaj aktiviteteve kulturore dhe sportive
Mbështetja e sigurisë	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Mbështetja e mërgatës	Zbatim i plotë	Janë ndarë 5 milionë Euro për këtë masë si mbështetje ndaj mërgatës.
Mbështetja e ndërmarrjeve publike	Zbatim i plotë	Janë ndarë mjete financiare prej 10 milionë e 860 mijë euro për të mbështetur financiarisht ndërmarrjet publike.

Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient

Kjo masë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, është prej masave më të rëndësishme dhe zbatimi i së cilës ka rëndësi të madhe edhe për INDEP, meqenëse INDEP avokon për efikasitet të energjisë në periudhë 10 vjeçare. Kjo masë e pestë, ka të alokuar mjete financiare prej 100 milionë euro për zbatimin e saj. Kjo shumë parash është e dedikuar për projekte strategjike dhe investime që lidhen në një mënyrë ose tjetër me ruajtjen e ambientit.

Në raportin monitorues të Pakos së Ringjalljes për tre mujorin Shtator- Nëntor është paraqitur niveli i zbatimit të kësaj mase i cili fatkeqësisht atëbotë ka qenë në fazën 0, pra ende nuk pati filluar. Aktualisht situata qëndron njëjtë, dhe MFPT si dhe e gjithë Qeveria e Kosovës ende nuk ka filluar as prezantimin e projekteve apo investimeve që mendon të realizojë në kuadër të zbatimit të kësaj mase. Prezantimi i Pakos së Ringjalljes jepi shpresë për zbatimin edhe kësaj mase, me rëndësi të madhe për Kosovën. Masa në fjalë përmban edhe projekte me rëndësi shumëvjeçare për Kosovën si investime në filterët e TC Kosova B e projekte të tjera që përmirësojnë jetën e banorëve dhe cilësinë e ajrit në përgjithësi në Kosovë. INDEP konstaton se niveli i zbatimit të kësaj mase ende nuk ka filluar dhe kjo është alarmante për qytetarët e Kosovës, duke u nisur nga fakti se tash është koha e duhur për të vepruar për një rindërtim ndryshe edhe në këtë aspekt dhe për tu orientuar drejtë një të ardhme të gjelbër.

Përfundime

Duke qenë se Pakoja e Ringjalljes përmban masa tepër të rëndësishme për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies në Kosovë, pas periudhës së vështirë të pandemisë COVID-19, është tepër e nevojshme që këto masa ringjallëse të zbatohen në mënyrë të plotë. Masat kanë për synim që përveç se të rindërtojnë ekonominë, ta bëjnë këtë në mënyrë të qëndrueshme. Formalizimi i ekonomisë, fuqizimi i gruas, mundësi të reja të punësimit, skema të reja sociale janë disa nga objektivat kryesore që pako synon të përmbush. Duhet pasur parasysh se tani më shumë se kurrë është e nevojshme që institucionet të ndërhyjnë, në mënyrë që të përmirësohet standardi dhe cilësia e jetës së qytetarit kosovar.

INDEP, në analizën e periudhës dhjetor-shkurt të monitorimit të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes, ka vërejtur se është vazhduar me zbatimin e tyre, dhe kjo është bërë në masë më të madhe se në periudhën e parë. Përkundër asaj që procesi i zbatimit të masave nuk është lehtë i gjurmueshëm, për shkak të mungesës së standardizimit të të dhënave që dalin nga zbatimi i Pakos, INDEP konstaton se operacionalizimi i masave është duke u bërë ashtu sic është synuar, me përjashtime të vogla. Deri në shkurt të vitit 2022, zbatimi i nënmasave që janë zbatuar në plotëni janë gjithsej 7, 11 janë zbatuar në mënyrë të pjesshme, 3 në nivel të kufizuar, dhe pa zbatuar kanë mbetur 4. Këtu nuk përfshihet masa 5 që ende nuk ka filluar të zbatohet as në nivel fillestar. Kjo natyrisht përbën shqetësim serioz, sepse përveç që rëndësia e masës është e madhe duke pasur parasysh që energjia është temë aktuale, poashtu është momenti i fundit për të vendosur orientimin e Kosovës drejtë një të ardhme ndryshe.

Gjithsesi, masat tjera, duke përjashtuar masën 5 konsiderohet që janë në një nivel relativisht të pranueshëm të zbatimit. Masa e parë është duke u zbatuar, edhe pse ka dy nënmasa që ende nuk kanë filluar zbatimin, nënmasat tjera janë duke u zbatuar në plotëni, madje për disa nga nënmasat janë rialokuar përsëri mjete financiare, që të vazhdohet me zbatimin e tyre edhe gjatë vitit 2022. Ndërsa zbatimi i masës së dytë lë për të dëshiruar, kjo prej faktit se ende nuk ka asnjë nënmasë të zbatuar plotësisht. Gjithsesi mjete financiare ka të alokuara për këtë masë, megjithatë pritet fillimi i ekzekutimit të subvencioneve për kreditë konsumuese si dhe nevojitet reagimi për masa të pazbatuara shpejtë. ‘Mbështetja për familjen’ si masë e tretë qëndron mirë në analizimin e zbatimit të nënmasave të saj. Vlen të theksohet se dy nënmasa të kësaj mase janë adaptuar si skema të përhershme, dhe përkundër që mjetet financiare lënë për të dëshiruar, është hap i domosdoshëm për rritjen e mirëqenies sociale. E fundit për nga zbatimi, masa 4 që ka buxhetin më të madh të projektuar për zbatimin e saj, qëndron relativisht mirë. Përvec të projektuar, ka edhe të ndarë buxhetin e nevojshëm, si dhe dy nga nënmasat e saj janë të zbatuara në tërësi. Megjithatë duhet pasur parasysh se ka nënmasa që dalin nga kjo masë që nuk kanë filluar as në nivel minimal zbatimin. Përgjithësisht mund të konstatojmë se niveli i zbatimit për këtë periudhë qëndron më mirë se në periudhën e parë tremujore, megjithatë duhet punuar ende me intensitet që të ketë rimëkëmbje të vërtetë dhe përmirësim të jetës së qytetarit kosovar, të cilën pandemia e ka gjetur në gjendje jo të mirë, por e ka lënë gati të shkatërruar.



“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë pikëpamjet dhe opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”